

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 395 Prot.

Tiranë, më 11.06 2015

VENDIM Nr. 53 datë 04.06.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore” (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.8, të datës 04.06.2015, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Dimali"* miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues të tij Prof. As. Belisa Muka dhe Prof. Michael Heinzelmann,

VENDOSI:

- I. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Dimali"* paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues të tij Prof. As. Belisa Muka dhe Prof. Michael Heinzelmann, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Vijimi i gërmimeve në nekropolin veri-perëndimor, në zonën e baptisterit.
 - Kryerja e sondazhit verifikues në zonën e nekropolit jug-lindor.
 - Të punohet paralelisht për studimin e materialit me qëllim përgatitjen për botim të vëllimit të parë, mbi rezultatet e punës së kryer gjatë periudhës 2010-2013.
- II. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë korrik-gusht 2015.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO